


REPUBLIKA KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVARE		PUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT		
ANTI-CORRUPTION AGENCY		
Dok. Dok. Dok.	2-D /DPK	Nr. Prot. Broj prot. Prot. No.
Nr. Lek. Buletin num. Nr. Dokument	02	Date Datum Date
		06-03-2013



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **30.01.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-2427/12, për ztr. *Bajram Jashari* – Drejtor i Bordit të Kompanisë së Ujësjellesit Rajonal “KUR Prishtina”, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Por, Zyrtari i Lartë është i obliguar që të bëjë deklarimin “rast për rast” të interesave private në situatat e shfaqjes së tij (Neni 13, i Ligjit Nr.04/L-051).

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-2427-12, për Zyrtarin e lartë, ztr. Bajram Jashari – Drejtor i Bordit të “KUR Prishtina”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-02-2427/12, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, pas procedurës së shqyrtimit, kemi konstatuar se nuk ka pasur prova të mjaftueshme që argumentojnë gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari Bajram Jashari (Drejtor i Bordit të Kompanisë Rajonale “KUR Prishtina”) nuk ka pozitë menaxhue se as rol vendimarrës në ndërrmarrjen hidro-ekonomike “Iber –Lepenc”.

Ushtrimi i këtyre funksioneve mund të sjell ndonjë situatë të konfliktit të interesit “rast për rast”, por, në baze të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit Neni 13 paragrafi 1, në këto situata Zyrtari është i obliguar që të bëjë deklarimin paraprak, rast për rast të interesave të tij private.

Kjo është e rregulluar me Nenin 13, paragrafi 1 në të cilin shprehimisht thuhet: ” Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik, në bazë të njohurive të tij dhe me mirëbesim detyrohet që të bëje vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat lidhur me vendimmarjen në një çeshtje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit”.

Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtar i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikqyrës. Deklarimin si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.(Neni 13, paragrafi 2).

Vet deklarimi si rregullë bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarje për ndonjë çeshtje të caktuar (Neni 13 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 04/L-051).

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korruptionit

/ Hasan Preteni

